

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

AKT NORMATIV

Nr.3 date 28.12.2015

PER
DISA NDRYSHIME NE LIGJIN NR.160/2014 “PER BUXHETIN E VITIT 2015”,
te ndryshuar

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

KESHILLI I MINISTRAVE
V E N D O S I:

Në ligjin nr.160/2014, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 4 ndryshohet si vijon:

Buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2015 është:

I. Skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror	
Të ardhurat, gjithsej	102 115 milionë lekë;
Nga të cilat:	
- kontributet	59 118 milionë lekë;
- transferimet nga Buxheti i Shtetit	35 822 milionë lekë;
- perdorimi i gjendjes nga viti 2014	6 000 milionë lekë;
- transferim per shperblime te pensionisteve	1 175 milionë lekë;

Shpenzimet 102 115 milionë lekë.

Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, përcaktohet nga Këshilli i Ministrave dhe ndryshon sa herë që rriten pagat dhe pensionet. Keshilli i Ministrave përcakton masen e kontributit për personat e vetpunësuar në bujqësi si dhe të kategorive të veçanta të personave të vetpunësuar duke mbuluar nga buxheti i Shtetit diferencën midis këtyre kontributeve me masën e kontributit të përcaktuar për personat e vetpunësuar në qytet. Për vitin 2015, teprica ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve sipas degëve të sigurimit shoqëror dhe programeve të tjera të veçanta e suplementare të përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.

2. Skema e sigurimit suplementar

Të ardhurat, gjithsej	5 571 milionë lekë;
Nga të cilat:	
- kontributet	770 milionë lekë;
- transferimet nga Buxheti i Shtetit	4 738 milionë lekë;
- transferim per shperblime te pensionisteve	63 milionë lekë;
Shpenzimet	5 571 milionë lekë.

Shpenzimet administrative, si pjesë e shpenzimeve totale për skemën e sigurimeve shoqërore, janë jo më shumë se 2 044 milionë lekë dhe ndahen sipas skemave në proporcion me shpenzimet e drejtpërdrejta.

Neni 2

Ne nenin 10 shpenzimet sipas grupeve kryesore ndryshojne;
“Shpenzimet e buxhetit qendror bëhen 344 733 milione lekë”
“Huadhënia për energjinë bëhet 2 000 milionë lekë”, dhe shtohen fjalët: “ nga e cila 1 000 milionë lekë jepet hua në formën e transfertës.”

Ne nenin 10 tabela nr.1 zëvendësohet me tabelën me të njëjtin numër bashkëlidhur.

Neni 3

Ky Akt Normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Ilir META